



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 91

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 30 maj 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 27.5.2024	Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian..... 10215
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 93, datë 27.5.2024	Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme..... 10217
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 280, datë 17.5.2024	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit’”, i ndryshuar..... 1022
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 366, datë 22.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Rumanisë.... 1022
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 367, datë 22.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut..... 10223
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 368, datë 22.5.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 128, datë 22.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Danimarkës”..... 10225
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 369, datë 22.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 10226
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 370, datë 22.5.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 781, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Belgjikës”..... 10226
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 387, datë 23.5.2024	Për delegim kompetencash..... 10227

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 14, datë 16.5.2024	Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durrës”	10227
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 15, datë 16.5.2024	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a.....	10228
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 16, datë 16.5.2024	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec sh.a.....	10234
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 2121, datë 11.4.2024	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Pëllumb Sulillari.....	10235



REZOLUTË

**PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR
MIRËQEVERISJEN, SUNDIMIN E
LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN
EVROPIAN**

Në zbatim të neneve 1, 2, 3, 6, 7, 75, pika 2, 77, pika 1, 78 dhe 80 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 24, 36, 68, 98, 102, 105, 106, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, bazuar në rekomandimet e raportit të BE-së për Shqipërinë 2023, raportit *screening* të Komisionit Evropian, si dhe në deklaratat/rezolutat e Samitit për Demokraci të SHBA-së;

Të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë, si shprehje përbashkuese e vullnetit të mbarë zgjedhësve pa dallime partiake dhe të të gjithë shqiptarëve kudo janë, për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian; në zbatim të parimeve dhe detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e republikës sonë; me bindjen e plotë në mundësitë e politikës dhe shoqërisë për t'iu përgjigjur domosdoshmërisë së një qasjeje kombëtare gjithëpërfshirëse në adresimin e sfidave të kësaj faze vendimtare për modernizimin e mëtejshëm të shtetit,

Ne, anëtarët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Duke e konsideruar moment kyç të historisë sonë të përbashkët rrugëtimin evropian të vendit përmes negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian, pas përfundimit me sukses të procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit (procesi *screening*) dhe vlerësimit të Këshillit të Bashkimit Evropian për arritjet e Shqipërisë në të gjithë sektorët, si edhe duke nënvizuar gatishmërinë e vendit për t'iu përmbajtur legjislacionit të BE-së në fushën politike, ligjore, ekonomike dhe sociale;

Duke shprehur vlerësimin e përbashkët për mbështetjen strategjike që Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja i kanë dhënë Shqipërisë në avancimin e reformave për konsolidimin e sundimit të ligjit, forcimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

Duke e vlerësuar reformën në drejtësi si një prej lëvizjeve më të mëdha shtetndërtuese në historinë e shtetit shqiptar – më e madhja në procesin historik të kalimit nga diktatura në një demokraci funksio-

nale – dhe duke e çmuar zbatimin e saj si një domosdoshmëri për jetësimin e parimit themelor kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet tri pushteteve, si dhe për të garantuar një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm, llogaridhënës, transparent, eficient, profesional dhe të barabartë për të gjithë qytetarët;

Duke vlerësuar rezultatet e derisotme pozitive të reformës në drejtësi, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet procesit të vetëqutimit për pastrimin e burimeve njerëzore në sistemin e drejtësisë, si dhe nëpërmjet veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila po kontribuon në mënyrë domethënëse në dhënien fund të epokës së pandëshkueshmërisë, duke shërbyer njëherësh edhe si një vlerë e shtuar besimi për vendimin e shumëpritur të hapjes së negociatave me BE-në;

Duke qenë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e njohjes së problematikave të vendit në këtë fazë vendimtare për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe adresimin e përbashkët të prioritetëve, veçanërisht në drejtim të mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe korrupsionit, duke u mbështetur kryesisht në gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në raportet e BE-së dhe raportin *screening* të Komisionit Evropian, të cilat kërkojnë një analizë të përbashkët objektive, një reagim të përbashkët institucional dhe një veprim të koordinuar midis të gjitha institucioneve përgjegjëse;

Duke e mbështetur angazhimin me plane masash konkrete të ekzekutivit dhe të të gjitha institucioneve të përfshira për të përmbushur detyrimet e procesit të negociatave dhe duke vlerësuar miratimin nga qeveria shqiptare të dy udhërrëfyesve të rëndësishëm: “Për shtetin e së drejtës” dhe “Për reformën në administratën publike”, si piketa hapëse të grupkapitullit të parë që njihet me emrin “Themeloret”;

Me vetëdijen e madhe për këto përgjegjësi të rëndësishme dhe për hapësirën gjithëpërfshirëse që i mundësohet Kuvendit nga Kushtetuta dhe autoriteti që i jep kuadri ligjor në fuqi, me bindjen se manifestimi i vullnetit politik dhe institucional i Shqipërisë në konceptimin, miratimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi përbën një përvojë të vyer institucionale për t'u zhvilluar më tej, si dhe me besimin e përbashkët se vendi ka nevojë për një cikël të ri reformimi në funksion të mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit, si domos-



doshmëri për përmbushjen e objektivit strategjik kombëtar të anëtarësimit në Bashkimin Evropian në vitin 2030,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë angazhohet:

1. Të nxisë frymën e dialogut konstruktiv politik dhe institucional brenda kuadrit kushtetues e ligjor ndërmjet tri pushteteve të pavarura, si dhe të gjithë aktorëve institucionalë e faktorëve politikë e shoqërorë në vend në funksion të një cikli të ri reformimi përmes një qasje të re gjithëpërfshirëse orientuese për aktivitetin e tri pushteteve të pavarura të republikës sonë, që, pavarësisht njëra-tjetrës dhe në harmoni me njëra-tjetrën, të angazhohen aktivisht për rritjen e ndërgjegjësimit institucional dhe forcimin e kulturës së bashkëpërgjegjësive së institucioneve në avancimin e mëtejshëm të reformave modernizuese të shtetit, në përmbushje të detyrimeve të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në kuadrin e Samitit për Demokraci të SHBA-së.

2. Të rrisë fokusin e Kuvendit të Shqipërisë në përsheptimin e procesit të anëtarësimit në BE për konsolidimin e demokracisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës, duke e konsideruar çështje madhore, të një rëndësie prioritare, thellimin e reformave për përmirësimin e mëtejshëm të mirëqeverisjes, fuqizimin e luftës ndaj korrupsionit, forcimin e zbatimit të ligjit, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

3. Të ushtrojë në mënyrë efektive përgjegjësitë e tij kushtetuese në lidhje me rolin mbikëqyrës të komisioneve të përhershme, komisioneve të posaçme dhe strukturave të tjera përgjegjëse parlamentare, ndaj qeverisë, institucioneve të pavarura dhe agjencive ekzekutive ligjzbatuese, brenda fushëveprimit të përcaktuar tashmë me Kushtetutë, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit midis pushteteve, me fokus të drejtpërdrejtë adresimin e masave të udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria “Për shtetin e së drejtës” dhe “Reformën në administratën publike”, si dhe rekomandimet e raportit *screening* të Komisionit Evropian.

4. Të përmirësojë rolin e tij ligjvënës, monitorues dhe mbikëqyrës në funksion të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet, ekzekutive dhe ligjberëse, qendrore e vendore, përmes mekanizmave dhe rregullave që fuqizojnë respektimin e ligjit dhe rritjen e transparencës në vendimarrje, aksesin e qytetarëve

dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ dhe vendimarrjen e qeverisjes qendrore e vendore, parandalimin e konfliktit të interesit dhe lobimit për interesa private, thellimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe kontrollin më të mirë ndaj tyre, përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës të pastërtisë së figurës së funksionarëve të lartë të zgjedhur ose të emëruar, forcimin e mekanizmave për kontrollin e integritetit të funksionarëve e zyrtarëve të të gjitha niveleve, ngritjen e mekanizmave funksionalë për transparencën financiare dhe zhvillimin e kulturës e qasjes demokratike të partive politike etj.

5. Të konsiderojë domosdoshmëri jetike për të ardhmen e vendit thellimin e luftës ndaj korrupsionit dhe fenomenit të pandëshkueshmërisë në mënyrë kapilare në të gjitha nivelet, duke e vendosur në fokus të shoqërisë shqiptare dhe të të gjitha institucioneve të shtetit, përmes një përpjekje të bashkërenduar nga Kuvendi, zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion, të shoqëruar me rekomandime masash konkrete ligjore, institucionale dhe administrative, veçanërisht për sektorët më vulnerabel ndaj korrupsionit (kadastra dhe të drejtat pronësore, taksat, doganat, arsimi, shëndetësia, përdorimi i fondeve publike, prokurimet publike, infrastruktura publike etj.), në të gjithë territorin e vendit.

6. Të thellojë më tej përpjekjet për forcimin e zbatimit të ligjit, duke mundësuar një proces analitik vlerësimi dhe rekomandimesh me masa konkrete ligjore dhe institucionale, që synojnë, ndër të tjera, reformimin, me të njëjtën ambicie dhe thellësi siç vepruam me reformën në drejtësi, edhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, që kanë në përgjegjësi luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe administrimit e pasurisë publike, krimin ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve dhe konfliktit të interesit, auditimin dhe inspektimin financiar, kontrollin e brendshëm, informalitetin apo mbikëqyrjen e tregut, regjistrimin e administrimit të pronës etj., duke synuar motivimin, integritetin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe efikasitetin më të mirë të këtyre strukturave në respektim dhe zbatim të ligjit në të gjitha nivelet e qeverisjes.

7. Të garantojë pakthyeshmërinë e reformës në drejtësi, konsolidimin e saj të mëtejshëm dhe rritjen e eficiencës së sistemit të drejtësisë në pritshmëritë e



qytetarëve shqiptarë, duke ruajtur parimet dhe shtyllat kushtetuese të reformës në drejtësi, të miratuar në vitin 2016, për të fuqizuar pavarësinë dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe njëherësh nxitjen e cilësisë së vetëqeverisjes së sistemit të drejtësisë nëpërmjet forcimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, sipas rekomandimeve të raporteve të BE-së dhe raportit *screening* të Komisionit Evropian për grupkapitullin e parë, si dhe masave të udhërrëfyesit “Për shtetin e së drejtës” në zbatim të tyre.

8. Të sigurojë në mënyrë transparente, në dispozicion të këtij procesi, ekspertizën më të mirë vendase e ndërkombëtare (veçanërisht me partnerët strategjikë, BE-në dhe SHBA-në) dhe përmes rregullave, procedurave e mekanizmave parlamentarë të ngrejë një komision të posaçëm parlamentar, i cili të adresojë ndërmarrjen e reformave që synojnë mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian përmes një vlerësimi/analize të situatës në këto fusha, si dhe hartimin e një Plani Kombëtar Veprimi, me kohështirje afatgjatë, duke rekomanduar, për sa çmohet e nevojshme, edhe masa konkrete për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale, të cilat duhet të adresohen në secilën fushë nga institucionet përgjegjëse. I gjithë procesi, që do të ndërmerret dhe mbikëqyret nga komisioni i posaçëm parlamentar, do të realizohet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet përkatëse në fuqi dhe në asnjë mënyrë nuk do të cenojë kuadrin ekzistues kushtetues e ligjor për ngritjen e institucioneve të pavarura të drejtësisë.

Ne, deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, i konsiderojmë detyruese përmbajtjen dhe angazhimet e kësaj rezolute, pavarësisht dallimeve dhe vijave të qarta ndarëse politike e programatike mes nesh në çdo aspekt dhe për çdo aspekt tjetër të jetës parlamentare.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miratuar në datën 27.5.2024.

UDHËZIM

Nr. 93, datë 27.5.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTACIONIT QË PARAQITET PËR APLIKIMIN DHE PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË ZAKONSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1 Vendi i aplikimit

1. Shtetasi shqiptar (në vijim “shtetasi”) aplikon për t’u pajisur me pasaportë biometrike:

a) brenda vendit: në zyrat e aplikimit pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në raste të veçanta, aplikimi mund të kryhet në institucionet shëndetësore, spitalore, shtëpitë e të moshuarve, në vendbanim ose ambiente të tjera, sipas kërkesës së Ministrisë së Brendshme;

b) jashtë vendit: në zyrat e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, të përcaktuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Në raste të veçanta, me miratim të Ministrisë së Brendshme, aplikimet mund të kryhen në vende të tjera përveç zyrave të Misioneve Diplommatike dhe Posteve Konsullore.

Neni 2 Aplikimi për herë të parë

1. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t’u pajisur me pasaportë biometrike, sipas nenit 1, duhet të plotësojë *online* nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania* formularin përkatës të vetëdeklarimit, si dhe të bashkëngjisë në portal një fotografi, sipas përmasave të përcaktuara në shtojcën 1, që i përcillet elektronikisht strukturës vendore të Policisë së Shtetit. Në rast se fotografia e dërguar nuk rezulton



sipas parametrave të shtojcës nr. 1, aplikimi refuzohet.

2. Kjo procedurë ndiqet edhe nga shtetasit të cilët nuk aplikojnë për herë të parë, por janë pajisur për herë të fundit me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011.

3. Në rastin kur prindi ose kujdestari ligjor aplikon për fëmijën nën 16 vjeç ose për persona nën kujdestari, ndiqet e njëjta procedurë.

4. Në çdo rast të aplikimit për pasaportë shtetasi shqiptar që ka mbushur moshën 16 vjeç duhet të paraqitet me një letërnjoftim elektronik të vlefshëm. Në rast se nuk zotëron një letërnjoftim të vlefshëm shtetasi duhet të aplikojë njëkohësisht edhe për këtë të fundit, përveç aplikimit fillestar për pasaportë biometrike.

Neni 3

Verifikimi i të dhënave të formularit të aplikimit

1. Në aplikimin për pasaportë biometrike sipas nenit 2, të dhënat e formularit të vetëdeklarimit me fotografi, verifikohen nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe përcillen elektronikisht ose fizikisht në Zyrën e Gjendjes Civile ose në Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore, brenda:

- a) 7 ditëve pune, për aplikimin me procedurë normale;
- b) 1 ditëve pune, për aplikimin me procedurë të përshpejtuar;
- c) 10 ditëve pune, për aplikimet jashtë vendit.

Neni 4

Pagesa për shërbimin

1. Për shërbimin e pajisjes së shtetasit me pasaportë biometrike, në çdo rast kërkohet pagesa e shërbimit nëpërmjet blerjes së një kuponi.

Neni 5

Ripajisja e shtetasve me pasaportë biometrike

1. Për ripajisjen e shtetasit me pasaportë, nuk zbatohet procedura e përcaktuar në nenet 2 dhe 3, të këtij udhëzimi.

2. Shtetasi aplikon direkt në zyrat e aplikimit, duke paraqitur kuponin dhe si mjet identifikimi letërnjoftimin elektronik, si edhe dorëzon

pasaportën ekzistuese. Për shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nevojitet rezervimi *online* i takimit për aplikim.

3. Në mungesë të pasaportës dorëzon vërtetimin e deklarimit të humbjes ose vjedhjes i cili kryhet *online* ose fizikisht pranë Komisaritit përkatës të Policisë së Shtetit. Për shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë deklarimi mund kryhet edhe pranë Misioneve Diplomatike ose Posteve Konsullore.

4. Për të gjitha aplikimet me procedurë të përshpejtuar, që nuk i nënshtrohen plotësisht të formularit të vetëdeklarimit për strukturat e Policisë së Shtetit, shtetasi mund të paraqitet për aplikim pranë çdo Zyre Aplikimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Nëpunësi i Shoqërisë për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike “IdentiTek” sh.a. (në vijim “Shoqëria”) informon shtetasin mbi procedurën e aplikimit dhe vijon me dëmtimin fizik të pasaportës së vjetër, duke prerë bandën e MRZ-së, e cila arkivohet. Pjesa tjetër e pasaportës i dorëzohet shtetasit.

Neni 6

Pajisja me pasaportë biometrike e shtetasve nën 16 vjeç

1. Shtetasi nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, aplikon për pasaportë në prani të paktën të njërit prind, të kujdestarit ligjor ose të përfaqësuesit me prokurë në të cilën është parashikuar në mënyrë specifike ky shërbim.

2. Për shtetasit mbi moshën 12 vjeç është e detyrueshme marrja e shenjave të gishtave gjatë procesit të aplikimit për pasaportë biometrike.

3. Shtetasit nën moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç pajisjen me pasaportë pa marrë shenjat e gishtave.

Neni 7

Vlefshmëria e pasaportës biometrike

1. Për shtetasit mbi moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç vlefshmëria e pasaportës biometrike është 10 (dhjetë) vjet.

2. Për shtetasit nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç vlefshmëria e pasaportës biometrike është 5 (pesë) vjet.



Neni 8

Afati i pajisjes së shtetasve me pasaportë biometrike

1. Pajisja me pasaportë biometrike kryhet sipas afateve të mëposhtme:

a) brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit me procedurë normale, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) brenda 3 ditëve pune nga data e aplikimit me procedurë të përshpejtuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) brenda 30 ditëve pune nga data e aplikimit në përfaqësitë diplomatike/konsullore, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në rast të një nevojë urgjente, të papara-shikueshme, të vlerësuara si të tilla nga Ministria e Brendshme ose nga organet drejtuese të shoqërisë, procedurat e parashikuara në nenin 8.1 mund të përshpejtohen.

3. Në rastet e parashikuara në nenin 8, pika 2, kërkesa për shoqërinë bëhet me shkrim, në rrugë elektronike ose shkresore.

4. Afatet e parashikuara në nenin 8, pika 1, pezullohen në rastet kur aplikimi kërkon verifikime shtesë nga institucione të tjera, jashtë kompetencës së Shoqërisë.

Neni 9

Tërheqja e pasaportës biometrike

1. Tërheqja e pasaportës kryhet pranë zyrave të shoqërisë të ngarkuara për shpërndarjen e pasaportës biometrike të cilat gjenden pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, si dhe në Misionet Diplommatike dhe Postet Konsullore.

2. Tërheqja e pasaportës mund të kryhet:

a) nga shtetasi mbi 16 vjeç, shoqëruar me letërnjoftimin biometrik dhe faturën e shpërndarjes;

b) për shtetasit nën 16 vjeç, tërheqja e dokumentit mund të kryhet nga njëri nga prindërit, kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor ose me prokurë ku të jetë specifikuar shërbimi përkatës. Në këto raste personi i ngarkuar për tërheqjen e pasaportës duhet të paraqesë për verifikim para nëpunësit, sipas rastit; letërnjoftimin e tij, një certifikatë familjare që vërteton cilësinë e tij, prokurën, si dhe faturën e shpërndarjes;

c) për shtetasit mbi 16 vjeç, në pamundësi fizike për t'u paraqitur personalisht pranë zyrave të

shpërndarjes, tërheqja e dokumentit mund të kryhet nga ana e një pjesëtari të afërt të familjes (bashkëshorti/bashkëshortja, prindi, fëmija madhor), kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor ose me prokurë ku të jetë specifikuar shërbimi përkatës. Në këto raste, personi i ngarkuar për tërheqjen e pasaportës duhet të paraqesë për verifikim para punonjësit të shoqërisë, sipas rastit, letërnjoftimin e tij, një certifikatë që vërteton lidhjen e tij me aplikuesin, prokurën, si dhe faturën e shpërndarjes.

Neni 10

Dërgimi me postë i pasaportës biometrike

1. Për raste të parashikuara në nenin 1, shkronja “b”, pasaporta biometrike mund të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar të sigurt të shtetit të huaj, në bazë të parapagimit të kryer nga vetë shtetasit që kanë aplikuar.

2. Në rastet e parashikuara në këtë nen, shtetasi plotëson një deklaratë para operatorit përkatës nëpërmjet së cilës deklaron adresën e saktë, si dhe merr përsipër përgjegjësinë e dërgesës.

Neni 11

Ripajisja me pasaportë biometrike para mbarimit të afatit të vlefshmërisë

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese në rastet e mëposhtme:

a) kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me një afat të caktuar vlefshmërie të pasaportës;

b) kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;

c) kur pasaportës i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;

ç) kur pasaporta është dëmtuar fizikisht;

d) kur pasaporta është deklaruar e humbur;

dh) kur pasaporta është kallëzuar e vjedhur.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të pikës 1, të këtij neni, për ripajisjen me pasaportë, shtetasit dorëzojnë pasaportën ekzistuese në zyrën e aplikimit, ndërsa aplikimi vijon sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Në rastet e parashikuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni, shtetasi vetëdeklaron humbjen ose vjedhjen e pasaportës biometrike *online* ose fizikisht pranë komisariateve të Policisë së Shtetit. Në rastet e parashikuara në shkronjën “dh”, të pikës



1, të këtij neni, shtetasi vetëdeklaron vjedhjen e pasaportës biometrike fizikisht pranë komisariateve të Policisë së Shtetit. Shtetasi mund të riaplikojë për pajisjen me pasaportë, vetëm pas lëshimit të vërtetimit mbi pranimin e vetëdeklarimit nga strukturat përkatëse. Të dhënat e vërtetimit regjistrohen në formularin e aplikimit nga operatori i Zyrës së Aplikimit dhe i bashkëngjiten praktikës. Më pas, aplikimi vijon sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, vetëdeklarimi mund të bëhet *online* ose pranë Misioneve Diplomatike dhe Posteve Konsullore.

5. Konsiderohet si pasaportë e dëmtuar fizikisht ai dokument biometrik që përfshin rastet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

a) të dhënat janë të padeshifrueshme ose të palexueshme;

b) është çngjyrosur faqja e të dhënave biometrike;

c) kur ka dëmtime kimike ose me bojë në ndonjë faqe të pasaportës;

ç) kur konstatohet mungesa, grisja ose dëmtimi fizik i ndonjë faqeje të pasaportës;

d) kur konstatohet dëmtimi i elementit elektronik të pasaportës;

dh) ka shënime nga persona të paautorizuar.

Neni 12

Dërgesa e informacionit mbi pasaportat e reja të prodhuara

1. Jo më vonë se 48 orë nga prodhimi i pasaportës biometrike, shoqëria dërgon raport ditor mbi pasaportat e prodhuara në mënyrë elektronike në strukturën përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me marrjen e raportit sipas pikës 1, të këtij neni, kryen këto veprime:

a) përditëson informacionin në sistemin e Kontrollit Kufitar që përdor Policia e Shtetit;

b) kryen çaktivizimin në këtë sistem të pasaportës së vjetër.

3. Protokollet teknike të komunikimit vendosen me marrëveshje midis drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe administratorit të shoqërisë.

Neni 13

Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të aplikimit

1. Formularët e aplikimit bashkë me dokumentacionin shoqërues, si: banda MRZ e pasaportës së mëparshme, vërtetimi i vetëdeklarimit të humbjes/vjedhjes që kanë shërbyer për aplikim, pasi administrohen fillimisht në Zyrën e Aplikimit, dërgohen për arkivim në zyrën qendrore të shoqërisë.

2. Kopjet e formularëve të vetëdeklarimit me fotografi administrohen nga Policia e Shtetit dy vjet pas mbarimit të vlefshmërisë së pasaportës.

3. Të gjitha aplikimet e kryera arkivohen në zyrën qendrore të shoqërisë.

4. Akses në këtë arkiv ka shoqëria, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme të autorizuar nga ministri i Brendshëm dhe çdo përfaqësues i institucioneve të tjera të autorizuar paraprakisht nga ministri i Brendshëm ose kur legjislacioni në fuqi ia jep këtë të drejtë.

Neni 14

Ruajtja dhe arkivimi i pasaportës biometrike dhe bandës MRZ

1. Banda e MRZ-së e cila pritët nga pasaporta e vjetër nga ana e punonjësit të shoqërisë, ruhet dhe arkivohet për një periudhë 10-vjeçare. Pas përfundimit të këtij afati banda e MRZ-së asgjësohet fizikisht nga shoqëria, e cila evidenton në mënyrë administrative të gjithë procesin.

2. Pasaportat biometrike të prodhuara që gjenden në Zyrat e Shpërndarjes, ruhen për një periudhë 18-mujore nga momenti prodhimit. Në rast se pas përfundimit të këtij afati shtetasi nuk është paraqitur për tërheqjen e dokumentit, vijohet me:

a) prerjen dhe arkivimin e bandës MRZ; si dhe

b) asgjësimin e pjesës tjetër të pasaportës biometrike.

Neni 15

Hartimi i formularëve tip për aplikim në e-Albania

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, miraton formularët tip të parashikuar në nenin 2, pika 1 dhe nenin 11, pika 3, të këtij udhëzimi, si dhe kryen përditësimin periodik të tyre.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare


1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ose struktura të tjera të autorizuara nga ministri i Brendshëm.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 289, datë 2.9.2020, “Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

SHTOJCA NR. 1**Kërkesat e fotografisë**

Madhësia	Gjerësia 40mm, lartësia 50 mm
Rezolucioni (dpi)	600
Parametrat e imazhit	Lartësia e kokës (deri në majën e flokëve), 34 mm, lartësia nga lart e fotos në majën e flokëve 5 mm, pamja ballore, e ndriçuar
Ngjyra e sfondit	E bardhë, e ndriçuar
Formati i fotografisë	jpg, jpeg ose png
Elemente të tjera	Pa syze optike me ngjyrë dhe refleks, pa elemente të karakterit fetar që mbulon pjesën më të madhe të fytyrës, joaksesor që mbulojnë veshët dhe pjesën e qafës. Flokët të hedhur pas veshit, të rregullt, që të mos mbulojnë sytë dhe veshët.



UDHËZIM

Nr. 280, datë 17.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
NR. 2365, DATË 26.11.2008, “MBI
ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR. 277, DATË 18.6.1997,
‘PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË
VERBRIT’”, I NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar, dhe pikën 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit’”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, paragrafi i tretë, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Për rivlerësim shqyrtohet dokumentacioni mjekësor i rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit”.

2. Në pikën 2/2 togfjalëshi “për tu pajisur me epikrizën”, zëvendësohet me “për të përgatitur dokumentacionin mjekësor të rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit”.

3. Pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“10/1. Dokumentacioni për ndjekjen e arsimit të mesëm të lartë merret nëpërmjet ndërveprimit mes Regjistrat Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

URDHËR

Nr. 366, datë 22.5.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E RUMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjtë 24-orësh;
- c) shpendë dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezët e shpendëve;
- dh) mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht;
- e) nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Rumanisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Botoșani	Balusești*	
2	Olt	Scornicești*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 189, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me



patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 367, datë 22.5.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*	Ndarja administrative e nivelit 3
Kratovo*		
Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Pehčevo*		
Makedonski Brod*		
Vraneštica*		
Drugovo*		

Debarca*		
Dolneni*		
Veles*		
Gevgelija*		
Radoviš*		
Vevčani*		
Tetovo*		
Bosilovo*		
Negotino*		
Ilinden*		
Struga*		
Jegunovtse*		
Valandovo*		
Demir Kapija*		
Mavrovo and Rostuša*		

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt vetëm nëse survejanca



demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në



një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 193, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 368, datë 22.5.2024

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
128, DATË 22.2.2024, “PËR DISA MASA
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E DANIMARKËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”;

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 128, datë 22.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Danimarkës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 369, datë 22.5.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Kroacisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
	Brodsko-Posavska	Orlovac*	
	Brodsko-Posavska	Bebrina*	
	Grad Zagreb	Stupnik*	
	Karlovačka	Karlovac*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 132, datë 22.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me

Faqe | 10226

patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 370, datë 22.5.2024

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 781, DATË 29.12.2023, “PËR DISA
MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES
SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BELGJIKËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 781, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Belgjikës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

**URDHËR****Nr. 387, datë 23.5.2024****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 13, 20 dhe 23 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neneve 1 dhe 2 të ligjit nr. 7/2024, “Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017, ‘Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës’, të ndryshuar”, kapitullin IV, të VKM-së nr. 120, datë 6.3.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Mirela Thanasi, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas VKM-së nr. 120, datë 6.3.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

2. Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani**

VENDIM**Nr. 14, datë 16.5.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.2.2023,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 16.5.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës’”

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me shkresën nr. 1338 prot., datë 19.3.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik dhe ligjor”, plotësimet me shkresën nr. 1338/2 prot. datë 22.4.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në licencën e Shoqërisë Rajonale Durrës sh.a.”, si dhe ndryshimet me shkresën nr. 1338/3 prot., datë 10.5.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në licencën e SHRUKD sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor dhe një nga



drejtuesit teknik të shoqërisë, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregulator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, me vendimin nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, z. Sedi Çausi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master shkencor në Hidroteknikë, në vitin 2015.

5. Drejtues teknik i shoqërisë z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master shkencor në Hidroteknikë, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

6. Drejtues i dytë teknik i shoqërisë z. Tonin Doda me titull “Inxhinier Markshajder” është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Dega Miniera (Specialitet i Markshajderit) në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregulator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i

Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 (a) dhe 2 (c) e vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës”, ndryshojnë si më poshtë:

a) Drejtues ligjor: z. Sedi Çausi;

c) Drejtues teknik: z. Tonin Doda.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 15, datë 16.5.2024

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME Durrës SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregulator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendim i KKRR-së nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Në mbledhjen e datës 16.5.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,



KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., me shkresën nr. 5194 prot., datë 29.9.2023, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimin (kanalizime) e përpunimin e ujërave të

ndotura (trajtim)” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime sipas tabelës nr. 1 të mëposhtme:

Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Durrës

Kategoria e konsumatorëve		Zona e shërbimit	
		Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara 2024–2025
A. Shërbimi i FU-së		Lek/m³	Lek/m³
Njësia Durrës	1. Konsumatorë familjarë	70	70
	2. Konsumatorë publikë	120	140
	3. Konsumatorë privatë	130	150
Njësia Kavajë	1. Konsumatorë familjarë	38	50
	2. Konsumatorë publikë	80	140
	3. Konsumatorë privatë	100	150
Njësia Krujë	1. Konsumatorë familjarë	35	48
	2. Konsumatorë publikë	80	140
	3. Konsumatorë privatë	100	150
Njësia Rrogozhinë	1. Konsumatorë familjarë	38/48	48
	2. Konsumatorë publikë	90	140
	3. Konsumatorë privatë	100	150
B. Shërbimi i KUN		Lek/m³	Lek/m³
Njësia Durrës	1. Konsumatorë familjarë	50	50
	2. Konsumatorë publikë	60	70
	3. Konsumatorë privatë	60	70
Njësia Kavajë	1. Konsumatorë familjarë	15	30
	2. Konsumatorë publikë	20	50
	3. Konsumatorë privatë	20	50
Njësia Krujë	1. Konsumatorë familjarë	8	10
	2. Konsumatorë publikë	12	20
	3. Konsumatorë privatë	12	20
Njësia Rrogozhinë	1. Konsumatorë familjarë	10	10
	2. Konsumatorë publikë	12	20
	3. Konsumatorë privatë	12	20
D. Tarifë fikse shërbimi		Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Durrës	1. Konsumatorë familjarë	150	200
	2. Konsumatorë publikë	150	300
	3. Konsumatorë privatë	150	300
Njësia Kavajë	1. Konsumatorë familjarë	100	200
	2. Konsumatorë publikë	100	300
	3. Konsumatorë privatë	100	300
Njësia Krujë	1. Konsumatorë familjarë	100	200
	2. Konsumatorë publikë	200	300
	3. Konsumatorë privatë	200	300
Njësia Rrogozhinë	1. Konsumatorë familjarë	50/100	200
	2. Konsumatorë publikë	100	300
	3. Konsumatorë privatë	100	300



2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., me shkresën nr. 5194/2 prot., datë 5.10.2023, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim” ka dërguar dokumentacionet plotësuese.

3. Me vendimin nr. 47, datë 10.11.2023, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Durrës.

4. Kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Durrës, për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021.

Shoqëria Rajonale UK Durrës aplikon tarifat e miratuara nga ERRU-ja për ish-shoqëritë UK ekzistuese sipas vendimit të KKRR-së nr. 31, datë 18.7.2017 për bashkitë Durrës dhe Shijak, vendimit nr. 29, datë 30.6.2010 për Bashkinë Kavajë, vendimit nr. 52, datë 28.10.2019, për Bashkinë Krujë dhe vendimit nr. 39, datë 27.12.2012 për Bashkinë Rrogozhinë.

5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale duke qenë se është një shoqëri me kosto shumë të larta të energjisë elektrike;

b) aplikimi për nivel të ri tarifar për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale;

c) reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele shumë të larta;

d) përmirësim i cilësisë së shërbimit të ujit me rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë;

f) tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit dhe në planin e biznesit.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Durrës sh.a. e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sa i takon moslejimit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;

e) orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Rajonale Durrës sh.a.:

a) instalimi i matësve në burim (*bulk meter*), si edhe në matësa familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është evident në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujemates;

c) të mbajë aktive vazhdimisht (jo me fushata) Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privatë (hotele, bare



dhe restorante), si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

d) të trajnojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

e) të ketë në vëmendje saktësimin e popullsisë së shërbyer në zonën e shërbimit me argumentet përkatëse që t'i përgjigjet realitetit, si dhe të mënjanojë raportimin e pakuptimtë veçanërisht për njësinë Krujë me rreth 9.7 banorë/lidhje;

f) të hartojë sa më shpejt, por brenda afatit për aplikimin tarifor të radhës, Planin e Biznesit 5-vjeçar si një instrument shumë i rëndësishëm në drejtim të menaxhimit me efikas të shoqërisë bazuar në objektiva konkrete të projektuara në 5 vjet, me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit;

g) të hartojë sa më shpejt, por brenda afatit për aplikimin tarifor të radhës, Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjet nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;

h) të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2025;

i) të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU-së referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës rregullatore, pra në vitet 2024–2025;

j) me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim, si: monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa *on-line* dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë;

k) të hartojë një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;

l) t'i kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit imediat të një studimi mbi eficiencën e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

9. Në mbledhjen e datës 18.4.2024, Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko-ekonomike, ERRU-ja e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifor, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.

10 Me shkresën nr. 134/1-10, datë 18.4.2024, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Durrës” ERRU-ja ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Durrës, Bashkisë Durrës, Bashkisë Kavajë, Bashkisë Krujë, Bashkisë Rrogozhinë, AKUK dhe Autoritetit të Konkurrencës.

11. Me shkresën nr. 1780/1 prot, datë 2.5.2024 dhe me shkresën nr. 1214/1 prot., datë 2.5.2024, me lëndë “Observacion mbi projektvendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.”, Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a. dhe AKUK kanë përcjellë kërkesën e tyre mbi rishikimin e këtij projekt vendimi. Me shkresën nr. 2282/1 prot, datë 25.4.2024, Bashkia Kavajë me lëndë “Shprehje e mendimit për nivel të ri të tarifave të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës ka sjellë në vëmendje mendimin e këshillit bashkiak të shprehur me vendimin nr. 69, datë 30.10.2023. Me shkresën nr. 2015 prot, datë 10.5.2024, me lëndë “Mbi dhënie mendimi për planin e ri tarifor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, për njësinë Rrogozhinë”, Këshilli Bashkiak Rrogozhinë ka përcjellë mendimin e tyre për planin e ri tarifor.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” dhe mori në konsideratë kërkesën e shoqërisë rajonale dhe të aksionarit kryesor AKUK-së për unifikimin e tarifave për



klientët jofamiljarë për shërbimin e furnizimit me ujë për njësinë Durrës dhe Shijak dhe njësinë Kavajë, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., si më poshtë:

Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU për Shoqërinë Rajonale UK Durrës

Kategoria e klientëve			Tarifat aktuale 2022	Tarifat e vendosura 2024–2026
ZONA A	Nj. Durrës dhe Shijak	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	70	70
		2. Klientë publikë	120	140
		3. Klientë privatë	130	140
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	50	50
		2. Klientë publikë	60	70
		3. Klientë privatë	60	70
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	150	200
		2. Klientë publikë	150	300
		3. Klientë privatë	150	300
ZONA B	Njësia Kavajë	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	38	50
		2. Klientë publikë	80	140
		3. Klientë privatë	100	140
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	15	30
		2. Klientë publikë	20	50
		3. Klientë privatë	20	50
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	100	200
		2. Klientë publikë	100	300
		3. Klientë privatë	100	300
ZONA C	Njësia Krujë	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	35	48
		2. Klientë publikë	80	96
		3. Klientë privatë	100	100
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	8	10
		2. Klientë publikë	12	20
		3. Klientë privatë	12	20
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë familjarë	100	200
		2. Klientë publikë	200	300
		3. Klientë privatë	200	300
	Njësia Rrogozhinë	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	48	48
		2. Klientë publikë	90	96
		3. Klientë privatë	100	100



		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë familjarë	10	10
		2. Klientë publikë	12	20
		3. Klientë privatë	12	20
		C. Tarifë fikse shërbimi	Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/ lidhje
		1. Klientë familjarë	50	200
		2. Klientë publikë	100	300
		3. Klientë privatë	100	300

2. Objektivat e treguesve të performancës të vendosura nga ERRU-ja

Referuar treguesve aktuale të performancës së shoqërisë rajonale UK Durrës, planeve të veprimit për përmirësimin e tyre, si dhe efektin e pritshëm ekonomik të tarifave të miratuara nga ERRU-ja, objektivat që duhet të realizojë kjo shoqëri gjatë implementimit të tarifave të reja deri në fund të vitit 2025 jepen në tabelën 3.

Tabela 3. Objektivat e treguesve të performancës (TKP's)

TKP	Nr.	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Objektivat nga ERRU-ja në fund të vitit 2025
Mbulimi me shërbime	1.1	Mbulimi me FU	%	97.8
	1.2	Mbulimi me KUN	%	65.4
	1.3	Mbulimi me trajtimin e UN	%	57
TKP Teknike	2.1	Uji pa të ardhura	%	69
	3	Niveli i matjes	%	99
	4	Vazhdimësia e FU	orë/ditë/popullsi	13.8
	5.1	Eficienca e energjisë	kWh/m ³	1.35
	6	Eficienca e stafit	nr/nr/1000	2.02
Shërbimi ndaj Klientit	7.1	Ankesat e klientëve	%	1.89
	7.2	Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje	%	100
TKP Financiare	8.1	Norma korrente e arkëtimit	%	83
	8.2	Norma e përgjithshme e arkëtimit	%	100
	9.2	Mbulimi i kostove O&M	%	63.7
	10.1	Mbulimi i kostos totale	%	57.6

3. Pagesa rregullatore vjetore për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. do të jetë 0.77% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. UK Rajonale Durrës detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU-ja dhe shlyerjen e pagesës rregullatore” brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Vendimet e KKRR-së nr. 31, datë 18.7.2017, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Durrës dhe Shijak”, vendimi nr. 29, datë 30.6.2010, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Kavajë”, vendimi nr. 52, datë 28.10.2019,

“Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a.” dhe vendimi nr. 39, datë 27.12.2012, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Rrogozhinë”, shfuqizohen.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 15.6.2024 dhe është i vlefshëm deri më 31.12.2026.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**



VENDIM
Nr. 16, datë 16.5.2024

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME POGRADEC SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 16.5.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), me vendimin nr. 18 datë 28.4.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a.” ka licencuar Shoqërinë Rajonale UK Pogradec për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura për një afat 4-vjeçar.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a., me shkresën nr. 377 prot., datë 15.4.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime, Shoqëria Rajonale UK Pogradec në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU-së për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe ITUN;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

c) Plani 5-vjeçar i Biznesit, ku të paraqitet edhe programi investimeve dhe aseteve të reja, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë metodologji nga ERRU-ja, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

d) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifar. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *Excel* të miratuar nga ERRU-ja;

e) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

f) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

g) mendimin e pushtetit vendor për tarifat e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

h) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

i) procesverbali i seancave dëgjimore me publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

j) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregulatore të tarifave të propozuara;

k) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me Marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;

l) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për



zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

m) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohe ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;

n) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese, si dhe aktmarrëveshjet midis palëve shitës-blerës;

o) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator pasi arriti në përfundimin se aplikimi i

Shoqërisë Rajonale UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021 dhe kuadrin rregullator në fuqi:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 2121, datë 11.4.2024, vendosi të shpallë të vdekur, më datë 14.5.1997, shtetasin Pëllumb Muharrem Sulillari.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 96 lekë